


Moti i keq shënon viktimitë e parë! Aksidentohet ambulanca në Maminas, humb jetën e moshuara, po dërgohet në spital në Tiranë pasi ishte me COVID



Vendi nën 'pushtetin' e borës, akset të kalueshme me zinxhirë! Bllokohen 11 fshatra në Elbasan, qindra qytetarë e kalojnë natën në makinë në Lezhë! Në Dibër trashësia arrin deri në 1 m



Kukës, debora krijon problematikë brenda qytetit, kalimi i mjeteve me vështirësi! Akset nacionale të kalueshme vetëm me zinxhirë



Shuhet nga COVID-19 në moshë të re montazhier i Klan Tv, sapo ishte bërë babai! Dy ditë më parë i ndërroi jetë i ati



Rama reagon për pezullimin e mjekut të QSUT-s: Lajm shumë i mirë, ka pasur një denoncim nga drejtori i spitalit

Tritol hotelit të drejtorit të Sigurimeve Shëndetësore në Sarandë, shpërthimi ndodhi pasi roja ndezi dritat (EMRI-VIDEO)

Report Tv raporton se një shpërthim i fuqishëm ka ndodhur në Sarandë. Shpërthim i fuqishëm ka ndodhur në hotelin e drejtorit të Sigurimeve Shëndetësore në Sarandë Mariel Murati, që është në rikonstruksion

- I shpërthyen hotelin me tritol, kush është Mariel Murati, ish-drejtor i ALUIZNI- t në Sarandë
- Shpërthimi në Sarandë, hoteli në pronësi të drejtorit të FSDKSH-së, dalin pamjet nga vendi i ngjarjes

Një shpërthim i fuqishëm me eksploziv ka ndodhur mbrëmjen e sotme në Sarandë në lagjen nr. 4.

Report TV mëson se shpërthim i fuqishëm ka ndodhur në hotelin e drejtorit të Sigurimeve Shëndetësore në Sarandë, Mariel Muratit, pallati i të cilit është në rikonstruksion. Mariel Murati ka qenë më parë në krye të ALUIZNI-t në Sarandë.



LEXO EDHE: Tritol hotelit të tij në Sarandë/ Pas 3 ditësh, ende askush në pranga! Drejtori i Sigurimeve: Asnjë konflikt, duan të më dëmtojnë imazhin

Tritoli ishte vendosur në tarracën e hotelit. Dyshohet se tritolit ka qenë i lidhur me rrjetin elektrik, pasi ka shpërthyer në momentin kur roja ka ndezur dritat.

Nga shpërthimi nuk raportohet për persona të plagosur, por vetëm për dëme materiale, ku siç shihet janë disa xhama të thyer.

"Më datë 09.02.2021, rreth orës 20:15, në lagjen Nr.4, Sarandë, në një objekt në rikonstruksion në pronësi të shtetasit M. M., ka shpërthyer një sasi e vogël lëndë plasëse, ku si pasojë ka vetëm dëme të vogla materiale. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar forcat e Policisë dhe grupi hetimor ku vijon veprimet për sqarimin e rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorit." njofton policia.

Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 21:46

I shpërthyen hotelin me tritol, kush është Mariel Murati, ish-drejtor i ALUIZNI- t në Sarandë



Personi që shihni në foto është Mariel Murati, pronar i hotelit, të cilit mbrëmjen e sotme i vendosën tritol, me detyrë drejtor i Sigurimeve Shëndetësore në Sarandë.

Mariel Murati më herët ka qenë drejtor i Aluiznit në Sarandë.

Ndërsa në vitin më 2018 është emëruar Sekretar Organizativ i Partisë Socialiste për Sarandën.

Ora 20:20

Shpërthimi në Sarandë, hoteli në pronësi të drejtorit të FSDKSH-së, dalin pamjet nga vendi i ngjarjes



Burime për Report Tv bëjnë me dije se shpërthimi ka ndodhur në hotelin e drejtorit të FSDKSH-së në Sarandë, Mariel Muratit. Murati ka qenë më parë ish-drejtor i Aluizinit.

Fatmirësisht nga shpërthimi nuk ka pasur të lënduar në njerëz, por vetëm dëme materiale.

Siç duket edhe nga pamjet e siguruara nga Report TV, janë thyer xhamat e lokalit, dhe të objekteve përreth.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: [sarande](#) [shperthim](#) [fsdksh](#) [mariel murati](#)

Ndalohet reptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A mendoni se janë marrë masat e duhura për përballimin e situatës së krijuar nga moti i keq?

PO JO Nuk kam mendim

Komento

Komente

Ligji:

09/02/2021 23:37

Ky shpërthim ka lidhje me detyren por me detyren e zbatuar mbrapsht nga ky ish drejtor Aluizni. Pak troje kane tjetersuar dhe vjefhur keta? Lexova diku se e kishin shkarkuar per korupsion nga Aluizni dhe partia e paska bere serish drejtor. Njerezit e pafuqishem per te gjetur drejtesi gjejne menyra alternative per ta vendosur ate. Nuk jam dakord me kete akt terrorist, por nga ana tjeter duhet ta themi shoqj qe shume zyrtare dhe ish zyrtare pervec korupsionit duhet te denohen dhe per krime kundra njerezimit. Kane vjedhur prona, kane prishur jeten e njerezve, i kane torturuar duke sorolloruar dhe mos ju dhene zgjidhje ligjore njerezve neper zyra duke ju marre vite jete. Ja ku e ka rastin Spaku per hetimin e pasurise dhe ligjshmerine e saj. Te gjenden terroristet por te hetohet dhe ky ish drejtor i Aluiznit.

Përgjigju

Manjola:

09/02/2021 20:50

Nga ky lajm kuptova nje gje te rendesishme: qe te caktohesh apo emerohesh (qe te perzgjidhesh konform procedurave te rregullta dhe objektive per nepunesit, sbehet fjale) qe kreret e organeve ne nivel qendror e lokal duhet te kene te paktën edhe nje biznes. Ky i Sarandes paska hotel. Hm. Vite me pare ne nje konference ne UK nje zyrtar britanik tha se adminstrata atje eshte e shenjte. Duhet te jape sherbime ne kohe paqe e lufte. Dhe qe te behesh pjese duhet te perzgjidhesh por edhe ta zgjedhesh si punesim. Sepse nese behesh pjese, nuk mund te merresh aktivisht me parti politike apo biznes. Duhet te zgjedhesh. Tani e kuptoj qe anglezi eshte shekuj mbrapa nesh. Mbaste pas ri-reformes ne shendetesi qe Kryeministri lancoi sot (dhe qe nuk e di pse e ka aq shume per zemer, ndoshta Beqja ia ka mbushur mendjen se mund te gjenerojne edhe 500 mil euro te tjera???!) dhe 0as reforms te sukseshme ne drejtesi, do te nisin nje reforme rrenjesore ne administrate. Kesaj here duhet te vendosin vetes te forte: kush nuk ka kontribute me vota, apo te kete marre nga LSI antare deri ne 100 persona, apo nuk ka biznes a eksperience ne krim te organizuar e pastrim parash, nuk mund te behet pjese e administrates. Rasti i sotem gjynaf per njerzit (bomba), por do jete kriminale me origjine dhe jo terroriste, do thojte policia. Se ne Shqiperi shperthimet me bomba jane vetem kriminale per larje hesapesh ose hesape te palara e thara. Thjesht imagjinoj nje shperthim te tille ne Londer, Paris apo Berlin. Edhe ata "kriminale" do ta quajne apo terroriste??? Qe te ulin nivelin e "terrorizmit" BE duhet me shembull nga ne e si behet administrata. Keshtu qe edhe nese do i vene bomben, te mos shqetesohen se nuk do jete per pune terroristi....

Përgjigju

Boti:

10/02/2021 07:39

Mariel drjtori me diplome kristali me diference vitesh nga shkolla e mesme. Hm. Me hotel. Fotot i ben te mira

Taku:

10/02/2021 00:16

Marieli eshte Cam, por cfar rendesie ka cfare eshte. Deri para 2013 ishte fotograf dhe e gjeti veten drejtor Aluizmi, pastaj u arrestua per korupsion, dhe tani eshte bere prap drejtor, bravo Mariel

Trëndelina:

09/02/2021 23:04

Kujt ja thua moj motër?! Po merr vesh inglizi?! Shakatë mënjani; chapeau! për ç'ke shkruar

Anonim:

09/02/2021 21:38

Hahah.. Ke te drejte ne cdo fjali qe thua!

vlor:

09/02/2021 21:37


çam esht ky mre murati ë

Lajme të tjera



1 metër dëborë në Dibër, rrugët rurale të bllokuara, aksi Peshkopi-Tiranë me zinxhirë (VIDEO)

14 Shkurt, 08:47



Pamje fantastike, Parku Kombëtar i Llogarasë 'vishet' me të bardha (FOTO)

14 Shkurt, 08:39



Berati i 'një mbi një dritareve' zbardhet nga debora (VIDEO)

14 Shkurt, 08:38



Shën Valentini vjen ndryshe këtë vit, Tirana 'vishet' me petkun e bardhë të dëborës (PAMJET)

14 Shkurt, 08:34



Dëbora bllokoi disa fshatra në Korçë, akset nacionale të kalueshme vetëm me zinxhirë

14 Shkurt, 08:26



Bllokohen rrugët në zonat malore të Krutës për shkak të ngricave, izolohen 3 mijë banorë

14 Shkurt, 08:17



RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com



MINUTË PAS MINUTË

- 09:20**
Kukës, debora krijon problematikë brenda qytetit, kalimi i mjeteve me vështirësi! Akset nacionale të kalueshme vetëm me zinxhirë
- 08:57**
1 metër dëborë në Dibër, rrugët rurale të bllokuara, aksi Peshkopi-Tiranë me zinxhirë (VIDEO)
- 08:42**
Pamje fantastike, Parku Kombëtar i Llogarasë 'vishet' me të bardha (FOTO)
- 08:39**
Berati i 'një mbi një dritareve' zbardhet nga debora (VIDEO)
- 08:35**
Shën Valentini vjen ndryshe këtë vit, Tirana 'vishet' me petkun e bardhë të dëborës (PAMJET)



MOTI		Shqiperi	
Qytetet	Diel	Hënë	Martë
Tirana	-2.26°C	-6.65°C	-3.83°C
Korçe	-5.88°C	-10.86°C	-11.77°C
Shkoder	-3.35°C	-3.93°C	-2.04°C
Gjirokaster	-3.85°C	-6.44°C	-5.77°C

Me të lexuarat e ditës Me të lexuarat e javës

Lajme **Fotogaleri** **Videogaleri**

- Moti i keq shënon viktimitë e parë! Aksidentohet ambulanca në Maminas, humb jetën e moshuara, po dërgohet në spital në Tiranë pasi ishte me COVID
- Vendi nën 'pushtetin' e borës, akset të kalueshme me zinxhirë! Bllokohen 11 fshatra në Elbasan, qindra qytetarë e kalojnë natën në makinë në Lezhë! Në Dibër trashësia arrin deri në 1 m
- Qindra qytetarë kalojnë natë të bllokuar në makina në aksin Lezhë-Milot
- Shën Valentini vjen ndryshe këtë vit, Tirana 'vishet' me petkun bardhë të dëborës (PAMJET)
- Dëbora bllokoi disa fshatra në Korçë, akset nacionale të kalueshme vetëm me zinxhirë
- Elbasan, bllokohen 11 fshatra, rrugët të ngrira të kalueshme vetëm me zinxhirë
- Entuziasmi qesharak dhe i pakuptimtë në Tiranë, për fitoren e Albin Kurtit
- Kosova voton sot, mbi 1 mln e 794 mijë qytetarë vendosin sot për qeverinë e re
- Pamje fantastike, Parku Kombëtar i Llogarasë 'vishet' me të bardha (FOTO)
- Berati i 'një mbi një dritareve' zbardhet nga debora (VIDEO)